VENDIM
Nr. 19, datë 16.2.2016

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "DRAGOBIA ENERGY" SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa "ç"; dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", neneve 4, pika 1, germa "f"; 5, pika 1, germa "f"; 13; 14, të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.2.2016, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Dragobia Energy" sh.p.k., mbi licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, si dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Dragobia Energy" sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "e", "f", "g") është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c", "d") është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/9, germat "a", "b" dhe "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Dragobia Energy" sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti